



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org.Jedritaria Org Unit	01
Nr.Prot. Broj Prot: Prot.No:	05-8796
Nr.i faqeve Br.stranica No.pages	- 2 -
Data: Datum: Date:	04/12/2020
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr.865/XII/2020

Datë:04/12/2020

Ministri i Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7, 01 Mars 2019), në zbatim të nenit 89 të Ligjit nr. 04/l-125 për shëndetësi, në zbatim të Nenit 4, nenit 5 paragrafi 2.5, Nenit 12 paragrafit 4, Nenit 19 paragrafi 1 të Ligjit nr. 07/l-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcës 7 të Rregullores Nr. 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në zbatim të Vendimit të Qeverisë Nr.01/42, datë 11/11/2020, në zbatim të rekomandimeve të IKSHPK-së me qëllim të kontrollit dhe parandalimit të përhapjes së virusit COVID-19, nxjerrë:

V E N D I M

1. Miratohen masat e veçanta për mbrojtjen nga pandemia COVID-19, në **Komunën e Junikut**.
2. Masat e miratuara në Komunën e **Junikut** janë si më poshtë:
 - 2.1 Operatorët ekonomik lejohen të punojnë nga ora 05:00 deri në orën 20:00, në përputhje me "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e COVID-19;
 - 2.2 Transporti publik lejohet të punoj duke shfrytëzuar deri në 50% të kapaciteteve, në përputhje me "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e COVID-19;
 - 2.3 Taksitë lejohen të punojnë me një (1) pasagjer prapa ose deri në tre (3) nëse janë anëtarë të së njejtës familje, në përputhje me "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid19";
 - 2.4 Qendrat tregtare lejohen të punojnë nga ora 05:00 deri në orën 20:00, në përputhje me "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e COVID-19;
 - 2.5 Veprimtaria e hotelarisë dhe gastronomisë ndalohet pas orës 20:00, përveç shërbimit "merr me vete" dhe "porosi me dërgesë";
 - 2.6 Lejohen pjesërisht aktivitetet kulturore të institucioneve vartëse të MKRS dhe komunave (teatrot, bibliotekat, filarmonia, galeritë, ansamblet, baleti, kinematë, qendrat rinore, muzetë, qendrat e kulturës me grupe dhe të ngjashme), duke shfrytëzuar vetëm 30% të hapësirës/sipërfaqeve të objekteve përkatëse për të gjitha aktivitetet (si në shfaqje ashtu edhe në ushtrime), në përputhje me "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e COVID-19";

- 2.7 Lejohen aktivitetet sportive në hapësira të mbyllura dhe të hapura; stërvitjet dhe garat mund të organizohen në sportet individuale; gjatë stërvitjeve në hapësirat e mbyllura mund të marrin pjesë deri në 20 persona, ndërsa gjatë garave mund të marrin pjesë deri në 50 persona bazuar në protokolle dhe udhëzime vendore dhe ndërkombëtare sportive, në përputhje me "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e COVID-19";
- 2.8 Lejohen fitneset dhe pishinat e mbyllura për aktivitete individuale rekreative duke shfrytëzuar vetëm 40% të hapësirave/sipërfaqeve, në përputhje me "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e COVID-19",
3. Dështimi në respektimin e këtyre masave në çdo rast, i nënshtrohet masave ndëshkimore në përputhje me Ligjin nr.07/1-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës nga ana e Institucioneve përgjegjëse të cilat janë të **obliguara** të mbikqyrin dhe të sigurojnë zbatimin e këtyre masave.
4. Ky vendim vlenë deri në një vendim tjetër, bazuar në situatën epidemiologjike në vend;
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i shëndetësisë në orën 18:00.

Arsyetim

Në bazë të vlerësimeve dhe rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, meqenëse Komuna e **Junikut** kategorizohet me rrezik të ulët të infeksionit, me qëllim të mbrojtjes së popullatës nga COVID-19, për të parandaluar përkeqësimin e gjendjes së menaxhimit të mjekimit nga institucionet shëndetësore lidhur me kapacitetet spitalore për trajtim, Ministri i Shëndetësisë në zbatim të Ligjit nr. 07/1-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Armend Zemaj

Ministër i Shëndetësisë

Vendim i dërgohet:

- Zyrës së Kryeministrit;
- Komunës së Junikut;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Zëvendësministrave të Msh;
- IKSHPK-së;
- Policisë së Kosovës;
- Inspektoratit sanitar;
- Inspektoratit shëndetësor dhe Inspektoratit farmaceutik;
- Inspektorateve komunale;
- Departamenti ligjor;
- Divizionit për komunikim me publikun;
- QOE-Msh;
- Sekretarisë së Komitetit për Covid-19;
- Arkivit të MSh.